

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Qendrën Shtetërore të Provimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 142/08, 148/09, 41/14, 55/16, 142/16 dhe 64/18), në lidhje me nenin 6 dhe nenin 15 pikat 1.1. dhe 1.2. nga Rregullorja për mënyrën, procedurën dhe kriteret e përzgjedhjes së bashkëpunëtorëve të jashtëm dhe përcaktimit të lartësisë së kompensimeve autoriale dhe të kompensimeve për shërbimet e tjera të Qendrës Shtetërore të Provimeve Nr. 01-440/3, nga 28.12.2022 dhe nr. 01-176/3 nga 1.3.2023, u. d. drejtor i Qendrës Shtetërore të Provimeve, solli:

K O N K U R S

për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm-përkthyes dhe lexues të pavarur

Qendra Shtetërore e Provimeve shpall konkurs për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm-*përkthyes dhe lexues të pavarur*, për nevojat e provimit të maturës shtetërore.

Bashkëpunëtorët e jashtëm angazhohen në rolin:

1. përkthyes - dy bashkëpunëtorë të jashtëm, përkatësisht:

- një për përkthim nga gjuha maqedonase në gjuhën turke dhe anasjelltas për lëndën **Matematikë**;
- një për përkthim nga gjuha maqedonase në gjuhën turke dhe anasjelltas për lëndën **Gjuhë Turke dhe Letërsi**.

2. lexues të pavarur - dhjetë bashkëpunëtorë të jashtëm për lëndët:

- **Gjuhë Maqedonase dhe Letërsi**;
- **Gjuhë Shqipe dhe Letërsi**;
- **Gjuhë Turke dhe Letërsi**
- **Gjuhë Angleze**;
- **Gjuhë Franceze**;
- **Gjuhë Gjermane**;
- **Gjuhë Ruse**;
- **Matematikë**;
- **Filozofi dhe**
- **Estetikë**.

Kualifikimet e nevojshme për përkthyes të materialeve të provimit nga provimi i maturës shtetërore:

Kandidatët që konkurrojnë për përkthyes të materialeve të provimit nga provimi i maturës shtetërore duhet të plotësojnë këto kushte:

- të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- të kenë të kryer të paktën studimet akademike të ciklit të parë në fushën përkatëse;
- të jenë nga radha e mësimdhënësve të lëndës përkatëse mësimore në shkollat e mesme në RMV ose nga radha e kuadrit arsimor-shkencor ose profesional nga universitetet në Republikën e Maqedonisë së Veriut për lëndën përkatëse, përkatësisht fusha përkatëse;
- të kenë të paktën 3 vjet përvojë pune në mësimdhënie;
- të jenë njohës të shkëlqyer të gjuhës burimore (gjuhës nga e cila përkthehet materiali) dhe të gjuhës së synuar (gjuhës në të cilën po përkthehet materiali).

Kandidatët për përkthyes të materialeve të provimit të maturës shtetërore duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

- fletë aplikimi (formulari i vendosur në ueb-faqen e Qendrës Shtetërore të Provimeve);
- një kopje të certifikatës/diplomës së arsimit të lartë përkatës;
- certifikatë origjinale e punësimit të rregullt dhe përvojë pune përkatëse prej së paku 3 vjetësh si mësimdhënës i lëndës përkatëse të lëshuar nga shkollat e mesme në RMV ose si pjesë e kuadrit mësimor-shkencor ose profesional nga universitetet në Republikën e Maqedonisë së Veriut për lëndën përkatëse, përkatësisht fushën përkatëse, të lëshuar nga universitetet e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Kualifikimet e nevojshme për lexues të pavarur:

Kandidatët që konkurrojnë për lexues të pavarur, duhet të plotësojnë këto kushte:

- të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- të kenë të kryer të paktën studime akademike të ciklit të dytë nga fusha përkatëse;
- të jenë nga radha e kuadrit arsimor-shkencor ose profesional nga universitetet në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga lënda përkatëse, përkatësisht fusha përkatëse;
- të kenë të paktën 5 vjet përvojë pune në veprimtari edukativo-arsimore ose shkencore;
- të kenë të publikuara punime profesionale, përkatësisht punime shkencore që janë në funksion të fushës përkatëse.

Kandidatët për lexues të pavarur duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

- fletë aplikimi (formulari i vendosur në ueb-faqen e Qendrës Shtetërore të Provimeve);
- një kopje të certifikatës/diplomës së arsimit të lartë përkatës;
- e punësimit të rregullt si pjesë e kuadrit arsimor-shkencor ose kuadrit profesional nga universitetet e Republikës së Maqedonisë së Veriut nga fusha përkatëse dhe përvojë pune përkatëse prej së paku 5 vjetësh në veprimtarinë edukative-arsimore ose shkencore;
- kopje të ballinës së punimeve të publikuara profesionale, përkatësisht punimeve shkencore të cilat janë në funksion të fushës përkatëse.

Qendra Shtetërore e Provimeve do të bëjë përzgjedhje sipas kriterëve të mësipërme, kurse kandidatët që do të hyjnë në rrethin e dytë do të intervistohen, pas së cilës do të vijojë përzgjedhja përfundimtare.

Kandidatët që do të përzgjidhen do të angazhohen për një periudhë prej **dy vjetësh**.

Kandidatët e interesuar mund të dorëzojnë dokumentet e duhura **më së voni deri më 30.3.2023**.

Dokumentacioni i dërguar pas afatit, i pavlefshëm dhe i paplotë, nuk do të merret parasysh.

Fletë aplikimi me dokumentacionin e duhur dërgohet me postë të rekomanduar në adresën: *Qendra Shtetërore e Provimeve - Shkup, rr. "Vasil Gjorgov" p.n. 1000 Shkup*, me shënimin për konkursin publik për bashkëpunëtorë të jashtëm-përkthyes dhe lexues të pavarur.

Informacione plotësuese mund të merren në numrin e telefonit **076/484-739**, çdo ditë pune.

QENDRA SHTETËRORE E PROVIMEVE